

**18.04.2023
Ora 11:00**

Shorti “Për caktimin e relatorëve për kërkesat ankimore nr. 49 dhe nr. 50”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: — Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 18 prill 2023, ora 11:00 zhvillohet procedura për hedhjen e caktimit të relatorit për hedhjen e shortit, për kërkesën ankimore numër 49 dhe 50, procedura është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku në dy janë shënuar kërkesat ankimore 49 dhe 50 të cilat pasi palosen vendosen në gogla me peshë, formë dhe ngjyrë të njëjtë, në një enë transparente, duke qënë se antarët e KAS-it nuk janë të pranishëm kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së të tërheqi në emër dhe për llogari të tyre goglat në enë transparente duke filluar nga rendi alfabetik rritës me zotin Ervin Lako të parin Elvis Cefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho. Pasi janë vendosur të 5 goglat në një enë transparente përzihen nga përfaqësuesi i KQZ-së.

-Tërhiqet gogla -Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. Ervin Lako: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. Elvis Çefa: -Kërkesa ankimore numër 49.

-Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. Ilirjan Rusmali: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. Koli Bele: - Kërkesa ankimore numër 50.

-Vazhdojmë në fund, në emër dhe llogari të:

Z. Ledio Braho: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Atëherë në përfundim të procedurës së shortit rezultati është përcaktuar relator i kërkesës ankimore numër 49 zoti Elvis Cefa dhe relatori i kërkesës ankimore numër 50 zoti Koli Bele, me kaq përfundon dhe procedura e shortit, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

**18.04.2023
Ora 17:10**

RENDI I DITËS

**“Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 49, subjekti ankues Partia
Demokratike e Shqipërisë”**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PS, BF, PD, PL

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën për vlerësimin paraprak të kërkesës ankimore me numër 49, me ankues subjektin zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë dhe me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 366, datë 15 prill 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndalimin e kandidimit të kandidatit për kryetar të Bashkisë së Mallakastrës, shtetasit Qerim Ismail Ismailaj, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Relator i kësaj kërkesë ankimore jam caktuar unë, Elvis Çefa. Para se të fillojmë me procedurën e zakonshme të bëjmë verifikimin e palëve prezent. Është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent përfaqësuesi i ankimuesit zoti Indrit Sefa, me autorizim, është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij, që në këtë procedim administrativ do të përfaqësojnë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Në këtë fazë a kemi kërkesa paraprake të regjistruara në KQZ?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjeta LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. I. Sefa: Nuk kemi.

Z. F. Nuri: Si përfaqësues i koalicionit Bashkë Fitojmë, kemi depozituar sot kërkesën për marrje pjesë e interesuar në shqyrtimin e çështjes së ankimit, nr. 49 ndër të tjera.

Z. E. Çefa: Dakord. Besoj sekretari i Përgjithshëm e konfirmon depozitimin e kërkesës?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. E. Çefa: Dakord. Atëherë, para se të dëgjojmë palët, a kërkesa paraprake në lidhje me përbërjen e trupit të KAS-it? Nuk ka. Atëherë, nuk kemi më pengesa për të vijuar shkurtimisht me sekretarinë Përgjithshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, atëherë do të procedojmë kështu: përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Bashkë Fitojmë duhet të argumentoni, ju lutem kërkesën tuaj ankimore dhe kryesisht legjitimitetin për fazën në procesin në të cilin jemi, para se të vijojmë pastaj me procedimin, në mënyrë që ne pastaj të vendosim nëse do t'ju pranojmë palë apo jo në këtë hetim administrativ.

Z. F. Nuri: Po, i nderuar, ne kemi marrë sot dijeni për ankimin në KAS, në subjektit Partia Demokratike e përfaqësuar nga zoti Sefa, ku ka kundërshtuar ndër të tjera dy vendime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, respektivisht vendimin 361...

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. I. Rusmali: Siç e lexoni kërkesën juve jeni për çështjen tjetër jo për këtë çështje që po shqyrtojmë.

Z. E. Çefa: Atëherë, do të vazhdojmë me sekretarin e Përgjithshëm që të relatojë kërkesën ankimore shkurtimisht dhe plotësimin e elementeve formale të kësaj kërkesë, duke qenë nuk ka kërkesë për palë të interesuara në këtë proces, po e them për efekt të procesverbalit, pra palë mbetet vetëm ankimuesi.

Z. Y. Merkaç: Më falni, nëse lexon kërkesën ankimore, kërkesën për marrje, pse jeni të interesuar për të futet si person i tretë, është kërkesa ankimore 49 dhe 50, thuhet në fillim të kërkesës.

Z. F. Nuri: Lapsus.

Z. E. Çefa: Atëherë, ju lutem, ju tërheq të gjithëve vëmendjen të jeni të kujdesshëm. Unë e lexova posaçërisht edhe kërkesën dhe shqiptova qartësisht emrin e kandidatit, i cili kërkohet nga ankuesit të hiqet nga ky proces zgjedhor. Kështu që në këtë fazë keni kërkesa paraprake është momenti për t'i bërë.

PS: Për atë i nderuar kryetar nuk kam në kuptimin e akteve administrative, por interesin e subjektit, jam përfaqësues ligjor, kam qenë dhe më herët në seancën e kaluar kur morët një vendim administrativ dhe do të vazhdoj ta përfaqësoj duke qenë se zoti Saliçani nuk ishte sot në cilësinë e përfaqësuesit ligjor dhe u njoftova para 30 minutash që do të zhvillohet kjo mbledhje në këtë moment.

Z. F. Nuri: Duhej ta paraqisnit si kërkesë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. A. Skënderi: Po, pra në cilësinë e kërkesave paraprake, po marr përsipër të përfaqësoj çështjen objekt gjykimi në lidhje me ankimin.

Z. E. Çefa: Pra, të hysh në këtë proces si palë e interesuar?

Z. A. Skënderi::Po.

Z. E. Çefa: KAS-i konsultohet në vend, dhe e pranon kërkesën, kështu që vijojmë me sekretarinë Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 49 me ankues Partia Demokratike Shqipërisë me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 366 datë 15. 04.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e deklarimit të subjektit vetëdeklarues zotit Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar të Bashkisë së Mallakastrës, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, ndalimin e kandidimit të kandidatit për kryetar bashkie të Mallakastrës, zotin Qerim Ismail Ismailaj, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore konstatohet se plotëson edhe elementet e formës dhe të përmbajtjes, pasi, referuar nenit 126 të Kodit Zgjedhor, kërkesa mban emrin e plotë të subjektit zgjedhor ankues, adresën e tij, referimin e ankimit që ankimohet, bazën ligjore, përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar, përshkrimin e fakteve, argumenteve dhe dispozitave në të cilat mbështetet ankimi, tregimin e provave, si dhe datën dhe firmën e ankimuesit. Gjithashtu, është në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor pasi është kompetencë e KQZ-së, në rastin

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

konkret KAS-it, i cili shqyrton vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve legjitimimin e ankuesit, plotësohet si dhe respektimin e afateve. Është brenda afatit ligjor, është paraqitur me datën 17.04, vendimi është dhënë më datën 14.04, kështu që është brenda afatit 2 ditor. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë, shkurtimisht ankuesi për elementet formale të ankimit, a kemi gjë për të thënë?

Z. I. Sefa: Jo, ne legjitimohemi si palë ankuese, për sa kohë që jemi ne që kemi vënë në lëvizje Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe Komisioneri na ka legjitimuar në vendimmarrjen e tij ku i ka dhënë përgjigje, sipas opinionit tim në lidhje me këtë vendimmarrje, dhe ne kemi bërë ankim në lidhje me vendimin e Komisionerit, i cili është vënë në lëvizje nga një kërkesë e paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike. Në këtë moment Komisioneri ka legjitimuar palën ankuese në këtë proces dhe ka marrë vendimin e tij duke u shprehur në themel të kërkesës sonë drejtuar Komisionerit. Si rrjedhojë, ne mendojmë që kjo çështje duhet të kalojë në seancë publike, dhe të shqyrtohet në tërësinë e ankimit dhe provave të paraqitura nga ana e Partisë Demokratike.

Z. E. Çefa: Unë kam një sqarim vetëm, meqenëse e keni fjalën, KAS-i e ka shqyrtuar një herë këtë kërkesë, por në kushte të tjera procedurale, apo jo? Pra, që ta kem edhe unë të qartë, ju menjëherë pas vendimit të KAS-it i jeni drejtuar me kërkesë Komisionerit direkt, apo jo?

Z. I. Sefa: Në datën 5 Komisioneri ka bërë një publikim në Facebook, ku ka deklaruar një vendimmarrje në lidhje me verifikimin *prima facia* të të gjithë

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

kandidatëve të Partisë Socialiste. Ne nuk kishim dijeni për këtë mbledhje publike të Komisionerit, dhe menjëherë në datën 6 i kemi dërguar një shkresë Komisionerit ku i kërkojmë që zotëria Qerim Ismail Ismailaj ishte në kushtet ndalimit, pasi nga provat që dispononim, që ishte vendimi i gjykatës, dhe të gjitha me radhë, mendojmë se është në kushtet e ndalimit. Ne, gjithashtu, ankimuaam vendimin e Komisionerit të datës 5 brenda afatit ligjor, sepse normalisht ishte një vendim, i cili duhet ankimuar për sa kohë që procedura ishte e tillë. Dhe KAS-i mori një vendim lidhur me atë. Nga e gjithë kjo periudhë nga data 6 që kemi depozituar ne kërkesën deri sa mori vendimmarrje KAS-i nuk ishte shqyrtuar kjo kërkesë nga ana e Komisionerit.

Z. E. Çefa: Kërkesa juaj nga Komisioneri?

Z. I. Sefa: Po. Pasi mbaroi shqyrtimi KAS-it, dhe nga ana jonë u bë edhe kërkesë padia në Kolegjin Zgjedhor. Komisioneri mori një vendim në lidhje me kërkesën tonë, dhe ne jemi të detyruar të bëjmë një ankim të dytë në lidhje me vendimmarrjen e Komisionerit posaçërisht për këtë kërkesë tonën. Komisioneri u vu në lëvizje nga ne, dhe i ka dhënë përgjigje një veprimi procedural të kryer nga ana e jonë.

Z. E. Çefa: Qartë. Atëherë, nga kolegët, a ka pyetje? Jo. Përfaqësuesi i palës së interesuar?

Z. A. Skënderi: Falemidnerit! Në lidhje me pikëpamjen formale të depozitimit nuk kam ndonjë ankesë, sepse kjo është shqyrtuar më parë nga juve dhe e keni të konsideruar të rregullt mënyrën e paraqitjes së kërkesës. Në lidhjet me detajet nëse

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

legjitimohet për ta kërkuar këtë gjë para komisionit kam rezervat e mia, të cilat ndoshta do t'i diskutojmë në një moment të dytë.

Z. E. Çefa: Nëse keni gjë për legjitimimin e ankuesit mund ta thoni.

Z. A. Skënderi: Dakord. Tani, duke pasur parasysh praktikën që ndoqi KAS-i të vendimit nr. 53 të datës 10.04.2023, ku konstatonte se vetëm Komisioneri ka deklaruar mungesën e legjitimitetit të këtij subjekti zgjedhor, për të kërkuar çregjistrimin e kandidatëve të tjerë, dhe konkretisht KAS-i, mesa lexova në arsyetim të vendimit që m'u vu në dispozicion sot, është bazuar te neni 3, pikat 7 dhe 2, që lidhet pikërisht me rrezikimin e kandidatit tjetër opozitar, dhe më të drejtën subjektive, që ka ky subjekt në lidhje me legjitimitetin. Kështu që, duke lexuar këtë arsyetim që keni dhënë më herët, bazuar në Kodin Zgjedhor dhe dispozitat konkrete, që keni referuar në vendimmarrje, mendoj se ka një mungesë legjitimiteti të subjektit të Partisë Demokratike për paraqitjen e këtij ankimi, duke lexuar në mënyrë të zgjeruar edhe nenin 124 të Kodit Zgjedhor, që vetëm ata subjekte të legjitimuara të paraqesin ankimin administrativ, njihen konkretisht. Dhe në rastin konkret nuk mendoj që Partisë Demokratike i cenohet diçka konkrete në raport me çështjen objekti ankimi duke qenë se nga tërësia e leximit të çështjes pothuajse janë të njëjta diskutime që janë bërë edhe herën e parë me diferenca të vogla, duke qenë se këta morën një informacion nga Komisioneri, atë ditë që bënë seancën gjyqësore, në lidhje me dokumentet e depozituara nga ana e Prokurorisë së Posaçme, të cilat i kanë shtuar në këtë ankim. Kështu që në këtë kuadër nuk mendoj, pastaj ju jeni që e vendosni në lidhje me faktin e legjitimitetit nuk e di nëse Partia Demokratike në këtë moment, me këtë kërkesë, me këto të dhëna për të cilat është gjykuar një herë më herët legjitimohet për të kërkuar për kandidatin tjetër rrezikimin apo synimin dhe

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

çregjistrimin më tepër të këtij kandidati nga zgjedhjet. Kështu që në këtë moment mendoj se do të ishte mirë që Komisioni të merrte në shqyrtim, në fakt, legjitimitetin, duke pasur parasysh parashikimet dhe vendimmarrjet e mëhershme, që po për këto subjekte dhe për të njëjtin shkak përgjigjur.

Z. E. Çefa: Dakord. Faleminderit! a ka pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Zoti Sefa, dakord, formalisht, ju bëni një ankim ndaj një vendimi të Komisionerit. Nëse i futemi argumentit brenda, nuk jam duke shtjelluar argumentin, por bëj një prezantim përpara, nëse i futemi argumentit brenda, të paktën një pjesë e argumenteve janë të karakterit penal do të thotë nga përmbajtja duket sikur jemi para një kallëzimi. Mos ka dyshime lidhur me kompetencën tonë për trajtimin e kësaj lënde?

Z. I. Sefa: Problemi është që nuk ka lidhje me kompetencën, sepse është përcaktuar me Kod Zgjedhor që kompetent është KAS-i dhe Komisioneri, dhe Komisioneri është kompetent për shqyrtimin e kushteve të lejimit ose të ndalimit të kandidatit për zgjedhje, dhe në këto rate është kompetencë e Komisionerit dhe vendimmarrja e Komisionerit mund të ankohet në KAS. Ajo që ne kemi paraqitur edhe në ankimin tonë që është dhe në dispozicionin tuaj, ka të bëjë me faktin e interpretimit tonë në lidhje me ligjin, sepse ka pasur një procedurë tjetër KQZ-ja, përpara ndryshimeve të vitit 2020 dhe ka një procedurë tjetër sot. Komisioneri, ka një praktikë, i cili nuk ka merr rol aktiv në shqyrtimin e këtyre çështjeve por e dërgon për kompetencë dhe interpretim në Prokurorinë e Përgjithshme, ndërkohë që KQZ-ja e mëparshme ka pasur një praktikë tjetër. Sa i përket asaj që ju pyetët që mund të ketë terminologji të karakterit penal, diskutimi është interpretimi që i bëjmë ne ligjit. Ne mendojmë që

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

kandidati që plotëson formularin e dekriminalizimit duhet të jetë shumë i kujdesshëm kur e plotëson formulairin e dekriminalizimit. Po të shikoni ai formular është shumë i detajuar, ka vendime të formës së prerë, ka vendime, të cilat nuk janë të formës së prerë.

Z. I. Rusmali: Të mos futemi tek ajo, janë dy-tri parashtresa, të cilat janë të kësaj natyre, natyrës së një denoncimi. Kjo ka lidhje me argumentin që vjen më pas, por nëse prisni diçka nga ne, përgjigjet për ato argumente?

Z. I. Sefa: Jo, jo.

Z. I. Rusmali: Nuk i prisni, i keni vetëm për introduksion.

Z. I. Sefa: Ato janë argumente, të cilat lidhen me interpretimin që i bëjmë ne ligjit, por nuk është se presim që ju të bëni kallëzim për formularin e dekriminalizimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kompetenca është e juaja për sa kohë është vendimmarrje në lidhje me lejimin ose të jo të kandidatit.

Z. E. Çefa: Pyetje?

Z. K. Bele: Thjeshtë për të kuptuar nenet se pastaj kjo duhet parë edhe në themel. Ju keni cituar edhe këtë aksiomën e së drejtës romake lege specialis derogatis lege generalis

Z. I. Sefa: Ligji i posaçëm nr. 138.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. K. Bele: Ju shpresoni që lege specialis, pra ligji i posaçëm në këtë rast është ky vendimi i parlamentit në raport me procedurën që ka të bëjë me dënimin?

Z. I. Sefa: Nuk është vendimi i parlamentit. Ai është një ligj i posaçëm që rregullon posaçërisht marrëdhënien e individit me pjesëmarrjen në jetën politike për të kandiduar ose jo. Dhe ai rregullon...

Z. K. Bele: Më falni, se mbase i rashë shkurt, ne nuk po merremi me jetën politike.

Z. I. Sefa: Ligji është për të rregulluar..

Z. K. Bele: Më lini të mbaroj! Siç e kuptoj unë, mund ta kem gabim, ju i referoheni vetëm në drejtim të interpretimit të termit “i dënuar”, “i padënuar” dhe ju doni të thoni që në këtë kuptim cili është legje specialis dhe cili është legje generalis.

Z. I. Sefa: Ligji i posaçëm është ligji nr. 138 i cili ka specifikuar, në mënyrë të detajuar, që për zbatueshmërinë e këtij ligji merret vetëm dënimi kryesor, dhe nuk interpreton asnjë dënim tjetër. Nuk i hyn fare interpretimit të dënimeve të tjera.

Z. K. Bele: Për çështjen “i dënuar”, “i padënuar” ky është ligji i posaçëm.

Z. I. Sefa: Vetëm për të konkurruar në zgjedhje, se pastaj, nëse ti ke jetën tënde dhe për të tretat, këto institucione, për të punuar në administratë ose për të bërë ndonjë gjë tjetër, për të marrë pjesë në tenderë për shembull, mjafton vendimi.

Z. K. Bele: Pra, kemi kodin si ligj të posaçëm për kudo tjetër dhe kemi...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. I. Sefa: Po jo, pra, se edhe në hierarkinë e normave, edhe ky me 3/5-tat është miratuar. Po ai ka një gjë më të madhe puna e Kodit, sepse e ka emrin Kod, kurse ky nuk e ka, se kodi i dekriminalizimit, edhe Komisioneri do të tundohej te kjo pjesë dhe nuk do të dinte kujt t'i jepte drejtim, por kod është. Dhe më e bukura është që ky kodi i dekriminalizimit ose ligji i dekriminalizimit mund të jetë votuar më me shumë vota se ai tjetri. Ky me 140, ai tjetri nuk e di të them të drejtën.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! KAS-i do të tërhiqet një 10 minutash, që ta diskutojmë çështjen dhe të vendosim pastaj për ecurinë.

Rifillon

ora 17:35

Z. E. Çefa: Atëherë, KAS-i pasi e vlerësoi çështjen vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës së ankiumuar nr. 49, me subjekt ankimues Partia Demokratike Shqipërisë, seanca e themelit të kësaj çështje do të zhvillohet nesër më datën 19 prill në orën 13.30, në këtë sallë. Seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 57

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

Data:18.04.2023

Ora 17:38

RENDI I DITËS

**Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 50, subjekti ankues Partia
Demokratike e Shqipërisë**

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti Politike:** BF, PL,PD

Z. K. Bele: Mirëmbërëma, edhe një herë! Çelim seancën publike të Komisionit të Ankimeve Sanksioneve për të verifikuar plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes, kërkesa ankimore nr. 50, datë 17.04.2023 të Partisë Demokratikë të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 361, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zgjedhjet në organet qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Shfuqizimi i vendimit nr. 362, datë 15.04.2023 të KSHZ-së për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar të këshillit bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet në organet vendore të datës 14 maj, ndryshimi i përmbajtjes së fletës së votimit, të vendosur të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 98, pika 3 të Kodit Zgjedhor, sipas propozimit të bashkëlidhur. Relatori i seancës, sipas shortit, jam zgjedhur unë, Koli Bele. Të pranishëm janë anëtarët e KAS-it, si dhe administrata e KQZ-së. Palë të tjera të interesuara të pranishme, të lutem!

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

Indrit Sefa –Partia Demokratike

Z. F. Nuri: Atëherë, i nderuar, ne kemi paraqitur kërkesë si koalicion “Bashkë Fitojmë” për të marrë pjesë si palë e interesuar në shqyrtimin e këtij ankimi.

Franci Nuri

Altin Kaziaj

Prezent

Z. K. Bele: Me 2 fjalë, ju lutem, argumenti, ju si palë e interesuar.

Z. F. Nuri: Me dy fjalë, meqenëse sot kemi marrë dijeni për ankimin në KAS të depozituar nga Partia Demokratike, përfaqësuar nga zoti Sefa, brenda afatit maksimal të lejuar, në gjykimin tonë, kemi paraqitur kërkesën për të marrë pjesë si palë e interesuar për shkak sepse nuk jemi dakord me kërkimet e ankuesit, për shkak se kërkitimi i tij na cenon dhe na prek përderisa kundërshton diçka, po themi, një element të përmbajtjes së fletës së votimit, në lidhje me koalicionin tonë, prandaj gjykojmë se kemi interes të ligjshëm të dëgjohemi dhe të shprehemi në KAS në lidhje me këtë kërkesë ankimore.

Z. A. Kaziaj: Zoti relator, të nderuar anëtarë të KAS –it, mbështes atë që sapo tha kolegu, për sa i përket pjesës së vendimmarrjes suaj themi dhe të atyre që kanë qenë vendimmarrjet e mëparshme tuajat, kështu që legjitimiteti në këtë rast është për sa i përket pjesës së ankuesit, që vë në lëvizje këtë komision, dhe duhet të shihet edhe pak në këndvështrim të vendimeve nr. 32, datë 23.01.2023. Për sa i përket pjesës sonë, ju e keni të administruar tashmë kërkesën për ndërhyrje në interes, duke qenë

*Zbardhi materialin audio
Eneida SFEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

se vetë ankimi, në thelb të vetë, ka cenimin e një vendimmarrje që ka të bëjë me subjektin që ne përfaqësojmë. Faleminderit!

Z. K. Bele: Atëherë KAS-i, i konsultuar në vend, vendos pranimin e kërkesës së palës për të qenë pjesë në proces dhe vazhdojmë procesin në këtë fazë, me kërkesa paraprake, nëse keni. Po, atëherë sekretari i Përgjithshëm.

Z. Y. Merhaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 50, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt: shfuqizimin e vendimit nr. 361, të datës 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatë për këshillin e Bashkisë së Tiranës, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Shfuqizimi i vendimit i nenit me nr. 362, datë 15.04.2023 i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatë për anëtarët e këshillit bashkiak në 60 bashki. Ndryshimi i përmbajtjes së fletës së votimit, duke vendosur të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 98, pika 3 të Kodit Zgjedhor sipas propozimit bashkëlidhur. Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore konstatohet se është në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor, pasi i plotësonte tri elementet e përmbajtjes, kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit, që është KAS-i në rastin konkret, legjitimitimi i ankuesit, i cili ankimon përmbajtjen e fletës së votimit, si dhe respektimin e afatit të ankimit, që është brenda afatit të 3 ditor. Kërkojmë që ankimi të kalojë për shqyrtim në seancë administrative. Faleminderit!

Z. K. Bele: Mirë, faleminderit! Ndonjë pyetje nuk besoj se kemi. Të dëgjojmë ankuesin e pastaj...

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

Z. I. Sefa: Për sa i përket legjitimitetit, të nderuar anëtarë, kemi disa vendime të vetë këtij organi dhe të Kolegjit Zgjedhor, të cilat edhe më parë janë marrë me këtë çështje teknike dhe kanë legjitimuar Partinë Demokratike edhe më parë. Është procedurë e kaluar dhe e konsoliduar në KAS dhe në Kolegj. Mjafton të përmendim vendimin nr. 19, 3.04.2021 dhe vendimin nr. 5, datë 04.04.2021 të Kolegjit Zgjedhor, që janë marrë edhe me një ankim të ngjashëm të Partisë Demokratike në zgjedhjet e 2021-shit, të cilat janë legjitimuar nga ky organ edhe nga Kolegji. Gjithashtu kemi edhe një interes të ligjshëm për sa kohë jemi dhe pjesë e fletës së votimit dhe normalisht dhe të gjitha argumentet që kemi parashtruar në këtë ankim vlejné edhe për respektimin dhe konsiderimin e barabartë të subjekteve përpara ligjit dhe pasqyrimin e tyre në mënyrë të barabartë, siç është përcaktuar ligji në fletën e votimit. Ndaj mendojmë që ky ankim duhet të kalojë në seancë publike në themel dhe duhet të gjykohet për të gjitha argumentet e paraqitura nga Partia Demokratike, si dhe provat bashkëlidhur.

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje për përfaqësuesin e Partisë Demokratike: a mund të na thoni, ju lutem, në çfarë pike ju cenon mënyra sesi është pasqyruar subjekti tjetër zgjedhor në fletën e votimit? Pra, interesat e Partisë Demokratike, ku cenohen? Keni frikë se ju konfondon emrin, ka elemente të ngjashme me partinë tuaj në fletën e votimit? Ajo nuk është fleta e votimit, ju lutem!

Z. I. Sefa: Në fletën e votimit është edhe kjo logo, është edhe logo tjetër. Në fletën e votimit ky është konditat i subjektit “Bashkë Fitojmë”, meqë e doni, se nuk e duan edhe emrin...

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

Z. A. Kaziaj: O, zoti Bele, tani nuk mund të bëjmë skena të kësaj natyre dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe përpara një organi kuazi gjyqësor.

(Diskutime pa mikrofon)

Z. K. Bele: Dëgjo këtu ka një standard, ne e dëgjojmë njëri-tjetrin.

Z. A. Kaziaj: Cili standard?

Z. K. Bele: Standardi është që ai do të thotë atë që mendon në interesin e çështjes së tij dhe t'i do të thuash atë që mendon në interes të çështjes tënde, po fjalën njëri-tjetrin nuk ia marrim.

Z. I. Sefa: Ky është personi që mungon në fletën e votimit, emri i të cilit del dhe me logon e ketë bashkë që janë kjo zemra e kuqe me blu, del dhe me logon e Partisë Demokratike. Është interes i ligjshëm ky? Ne duam që zgjedhësit kur të shkojnë të votojnë ta shohin, që kjo logo "Bashkë Fitojmë" të dinë që drejtohet nga drejtuesi i partisë, udhëheqësi i koalicionit, zoti Ilir Metaj, dhe ai qytetari të vijë i bindur që po voton Ilir Metën. Kaq, ai t'ia japi votën me dëshirë dhe vullnet të lirë pa besuar. Madje, Kolegji ka thënë që është e detyrueshme të jetë emri në vendimmarrje, logo, emri, simboli është e detyrueshme, thotë kolegji. KAS-i ka qenë pak me i butë, thotë që janë disa elemente që Komisioneri nuk ka të drejtë t'i cenojë, siç janë emri, logoja e të gjitha e me radhë se këto duhet të jenë patjetër në fletën e votimit, por formatin dhe standardin mund ta përcaktojë Komisioneri, por këto të dhënat e ligjit janë të detyrueshme për të qenë prezent në fletën e votimit. Unë besoj se interesi i ligjshëm

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

është këtu, plus që kemi këto vendimmarrje të tjera, që është gjë e gjykuar dhe ka kaluar në çështje themeli. Faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit, zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj: Tani pavarësisht se relatori i kësaj çështjeje apo kërkesë ankimore, zoti Bele, është me prejardhje nga Fieri dhe është i mirësjellshëm që të lërë, të themi, të disponojnë me fotografi me pamje filmike, këtu jemi te çështja.

Z. K. Bele: Me origjinë jam nga Voskopoja.

Z. A. Kaziaj: Prejardhje fisnike, e kisha. Më vjen keq që tolerohet një gjë e tillë, me gjithë respektin që kam. Tani lidhur me argumentin e kolegut, dikush, në emër të një subjekti tjetër ngre një pretendim, ndërkohë që subjekti të drejtat e tij dhe detyrimet mbrohen nga ne të dy, nga unë dhe nga kolegu Nuri. Flasim për një vendimmarrje, të themi, të natyrës të gjësë së gjykuar të dhënë edhe më përpara, lidhur me legjitimitetin e kam këtu në vetvete, të dhënë dhe më përpara. Jo më vonë se data 30.3.2023 Kolegji Zgjedhor, domethënë që është një organ suprem lidhur me çështjet zgjedhore, me vendimin nr. 6 po të kësaj date, nuk legjitimoji kolegun Sefa për të iniciuar një procedurë lidhur me pretendime të papasura si legjitimitet aktiv, të themi të tij, por kolegu Sefa, duke qenë se ju s'merrni asnjë vendimmarrje të natyrës lobuese kundrejt tij, duke parë dhe parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, e lini të abuzojnë me të drejtën e padisë, me të drejtën e ankimit dhe me çdo të drejtë që ai mendon se mund ta ketë. Unë e thashë edhe në seancën e fundit të Komisionerit, kolegu Sefa është nga natyra, le të themi, ankimues në vetvete, apelues

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

edhe po të kishte zgjedhje në Mal të Zi do të shkonte, do të inicioje një procedurë ankimimi, ndonëse pa pasur asnjë lloj legjitimiteti, e ka të tijën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di, nuk bëj statistika unë, zoti Bele, nuk merrem me statistika, dakord. Tani të them atë që doni juve, më thoni çfarë të them, na e jepni të shkruar dhe po e them atëherë.

Z. K. Bele: Thuaj çfarë të duash, po mos u merr me kolegun...

Z. A. Kaziq: Ndërkohë që juve...

Z. K. Bele: Merru me argument ligjor.

Z. A. Kaziq: E kisha vetëm për legjitimitetin.

Z. K. Bele: O Altin, më fal, dëgjo se ishim duke bërë dhe pak humor, po t'i kthehemi procesit. Ajo që po të kërkoj është hajde të merremi me argumentet. Ju të gjithë penoni dhe ne të gjithë e njohim njëri-tjetrin, kemi punuar prej vitesh, kështu që jep mendimin tënd për argumentin e atij.

Z. A. Kaziq: Për çfarë argumenti do të jap mendimin tim.

Z. K. Bele: Fol për çfarë jemi mbledhur sot, të lutem.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Po mos ma impononi mua. Unë normal që kam ardhur për të folur për atë që jemi mbledhur sot, zoti Bele, po më lini ta arrij atje, të paktën. Tani nuk do ju vonoj, as ju, as veten. Inicohet një procedurë ankimore për një mospasje thelbi nga ana e zotit Sefa dhe kërkohet që në fletën e votimit dhe në vendimin e dhënë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vihet emri i kryetarit të partisë, thotë kolegu, sipas parashikimeve të nenit 98, pika 3, ndërkohë që e lidhur kjo me nenin 65 pika 3, nuk flet ligjvënësi, ka një handikap ligjor, sipas këndvështrimit tim, të paktën, nuk flet ligjvënësi në asnjë rast për koalicionet, në këtë rast, flet vetëm për subjektet politike. Tani e dimë shumë mirë që, në këndvështrim të ligjit, koalicioni përbëhet nga 2 ose më shumë parti, ndërkohë që një nga elementet e formimit të koalicionit është edhe marrëveshja. Në qoftë se në marrëveshje nuk parashikohet se cili nga kryetarët e partisë do të rezultojë në fletë votimi, se nuk është një dakordësi e brendshme, kjo nuk do të thotë se do të gjejmë një kryetar dhe do ta vëmë. Fakti është që qëllimi në vetvete i fletës së votimit është ai i parashikuar nga ligjvënësi me indicet e caktuara. Emri i kryetarit në një subjekt politik është i detyrueshëm, emri i kryetarit në një koalicion është i interpretueshëm dhe jo i detyrueshëm. Kështu që në interpretim jua lë juve ta vlerësoni, ndërkohë që interesi ynë thelbësor është që të zbatohet ligji dhe jo të imponohet ligji nëpërmjet imponimeve që bën zoti Sefa dhe pranë një organi monokratik, dhe në këtë rast pranë një organi kuazi gjyqësor, që është një organ kolegjal. Kështu që mendojmë që të vetmin interes, në qoftë se e kemi, e kemi ne, dhe mospasja e emrit të një kryetari partie, në një fletë zgjedhore nuk është se i dëmton. Çfarë i dëmton në vetvete ata si subjekt politik, cilin subjekt dëmton? Pse nuk janë subjektet e tjera këtu, që ndihen të dëmtuara nga emri i kryetarit tonë apo nga emri i çdo kryetari? Pse nuk kanë bërë ankim subjektet e tjera, ndërkohë që zoti Sefa, specialist i ankimeve bën ankim? Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Enëfën STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

Z. L. Braho: Atëherë nga ndryshon ankimi i Partisë Demokratike, nga ankimi që keni depozituar ju për fletën tjetër të votimit, në lidhje me logon? Pse ju duhet të legjitimoheni aty, kurse këta nuk duhen legjitimohen?

Z. A. Kaziaj: Ja jua them unë. Faleminderit për pyetjen, është pyetje shumë e zgjuar siç janë pothuajse pjesa më e madhe e pyetjeve që ju personalisht bëni. Pjesa më e madhe jo të gjitha...

Z. L. Braho: Altin, në qoftë se është për të folur për procesverbal, flas edhe unë për procesverbal. Unë bëra një pyetje, përgjigjuni pyetjes! Nuk është nevoja t'u jepni vlerësim pyetjeve të mia.

Z. A. Kaziaj: Unë nuk jam i pandehur. Ju nuk jeni prokuror. Më lini të përgjigjem.

Z. L. Braho: Po as psikolog nuk je, as psikiatër.

Z. A. Kaziaj: Këtë nuk e dini ju. Tani, doni përgjigje, zoti Braho, apo nuk doni përgjigje? Mirë, faleminderit, po jua jap unë përgjigjen! Ankimi ynë ka të bëjë me mosvënien e asnjë logoje në fletën e votimit, jo vetëm me mosvënien e logos së një subjekti tjetër. Ky është ndryshimi. Ankimi i zotit Sefa ka të bëjë se pse nuk është vënë emri.

Z. L. Braho: Edhe ankimi i zotit Sefa është që të vihen emrat e të gjithë kryetarëve. Ju doni të hiqni të gjitha logot, ai do të vërë të gjithë kryetarët. nga ndryshojnë?

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Sipas meje, ka një ndryshim të madh. Logoja është një mjet identifikues, ndonëse është një kërkesë e ligjit në vetvete, por është një mjet identifikues i një subjekti të caktuar. Ndërkohë emri i kryetarit, jua thashë edhe pak më parë, për sa i përket pjesës së koalicionit nuk parashikohet si detyrë ose detyrim i Kodit Zgjedhor, parashikohet vetëm detyrim i parashikuar në pikën e tretë të nenit 98 për subjektet politike jo për koalicionet. Më thoni ju në qoftë se keni ndonjë dispozitë tjetër që më kundërshton në këtë gjë.

Z. K. Bele: Jemi te legjitimitimi, do të kemi argumente të themelit nëse do të shkojmë në themel.

Z. F. Nuri: Edhe unë bashkohem argumenteve të zotit Kaziaj, kolegut, që nëse ankuesit, zotit Sefa, i mungon legjitimiteti. Jemi ne si subjekt zgjedhor në këtë rast, si koalicion që po të kishim ndonjë kundërshtim ndaj vendimit të Komisionerit, në lidhje me emërimin për përmbajtjen e fletës së votimit për koalicion “Bashkë fitojmë” ne do të ishim ankuar, gjë që nuk e kemi bërë në lidhje me atë element specifik. Për shembull, në lidhje me këtë gjë, nuk e kuptoj as unë, sepse zoti Sefa cenohet, pra subjekti që ai përfaqëson, cenohet nga mosvënja e emrit të kryetarit të koalicionit, apo nuk e di si e ka emëruar. Ashtu sikundër e tha edhe kolegu Kaziaj, asnjë nga subjektet e tjera politike nuk është ankuar, përveç zotit Sefa, përfaqësuesit të Partisë Demokratike, në lidhje me mosvendosjen e këtij emri. Pra, nuk gjykojmë se ka interes të ligjshëm për t’u ankuar për një subjekt tjetër politik, në këtë rast koalicionin tonë. E duam apo jo ne si koalicion, e vendosim vetë. Nëse do ta kishim kërkuar, do t’ia kishim kërkuar Komisioneri Celibashi. Në qoftë se do të donim që të ishte një nga përfaqësuesit e partive politike, një nga kryetarët e partive politike pjesë përbërëse e koalicionit, do t’ia kishim kërkuar zotit Celibashi. Vetë nuk e

*Zbardhi materialin audio
Enxhida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt:18.04.2023*

duam, atëherë do të na i imponojë me zor KQZ-ja, që të kemi patjetër një emër aty. Në marrëveshjen politike, në mos gaboj, të më korrigojë kolegu Kaziaj, nuk është e përcaktuar midis partive të koalicionit nëse do të vendoset një emër apo jo për fletën e votimit. Dhe përderisa subjektet, pjesë përbërëse të koalicionit, nuk e kanë kërkuar dhe nuk po ankohen pse nuk ka emër, atëherë nuk e kuptojmë se çfarë interesi kanë subjektet e tjera në lidhje me emërtimin tonë. Pra, kjo është shkurtimisht. Gjykojmë se i mungon legjitimiteti dhe ndaj nuk duhet të kalohet fare në themel, për mendimin tim.

Z. K. Bele: Ka pyetje të tjera? Faleminderit! KAS-i do të tërhiqet për vendim. Do t'ju njoftojmë shkurtimisht lidhur me vendimin për këtë fazë të procesit. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 18:06

Z. K. Bele: Riçelim seancën. KAS-i, mbasi dëgjoi me vëmendje dhe morëm parasysh pretendimet e palëve, bazën ligjore, me shumicë votash, vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës dhe kalimin në seancë, duke caktuar si orar ditën e nesërme në datë 19.04.2023, ora 16.30. Faleminderit!

Vendimi nr. 58

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 51”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje anëtarët e KAS-it! Sot në datën 18 prill 2023 ora 18:10 po zhvillojmë procedurën për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore numër 51. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërën është vendosur kërkesa ankimore numër 51, me ankues Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt ankimi “Kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 360 dhe 363”. Shiritat e letrës pasi palosen nga një përfaqësues i KQZ-së vendosen në 5 gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë, në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it të pranishëm në zhvillimin e shortit kanë autorizuar përfaqësuesin e KQZ-së për t’i tërhequr në emër dhe për llogari të tyre, duke filluar nga rendi alfabetik rritës me zotin Ervin Lako emrin e parë, Elvis Cefa i dyti, zoti Ilirjan Rusmali i treti, Koli Bele i katërti dhe zoti Ledio Braho i pesti.

Perzihen goglat:

-Tërhiqet gogla e parë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. E. Çefa: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho: - Kërkesa ankimore numër 51.

Në përfundim të procedurës së shortit, relator i kërkesës ankimore numër 51 është caktuar zoti Ledio Braho. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

**18.04.2023
Ora 18.15**

RENDI I DITËS

Pranimi për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 51, me ankues Koalicionin “Bashkë Fitojmë”.

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho, Z. Ilirjan Rusmali.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** “Bashkë Fitojmë” (F. Nuri), PL (A. Kaziaj), PD (I. Sefa)

Z. L. Braho: Përshëndetje! Çelim seancën e shqyrtimit të elementeve të formës e të përmbajtjes së kërkesës ankimore nr. 51. Sot në datën 18.4.2023, në orën 15.55 subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr. 51, me objekt ankimi “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 360, datë 15.04.2023 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023; Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 363, datë 15.04.2023, “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për kandidat për kryetar bashkie në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” dhe “Shfuqizimin e këtyre vendimeve duke vendosur ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 61 bashkitë e vendit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, duke hequr logon e partive dhe/ose të koalicioneve nga përmbajtja e fletës së votimit për kandidatët për kryetar

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

bashkie”. Të pranishëm janë përfaqësuesit e subjektit ankues, koalicionit “Bashkë fitojmë”.

Z. F. Nuri: Franci Nuri prezent.

Z. A. Kaziaj: Altin Kaziaj.

Z. L. Braho: Ka ndonjë kërkesë, zoti Sekretar i Përgjithshëm, për palë të interesuar?

Z. Y. Merkaj: Në protokollin e KQZ-së nuk është paraqitur asnjë kërkesë.

Z. L. Braho: Po.

Z. I. Sefa: Indrit Sefa, përfaqësues i subjektit zgjedhor Partia Demokratike. Duke qenë se unë u njoha vetëm kur isha prezent në seancat e mëparshme në KAS dhe nuk kisha dijeni më parë në lidhje me kërkesën e paraqitur nga subjekti “Bashkë Fitojmë”, kërkoj të ndërhyj si palë e interesuar në këtë proces, pasi kam interes të ligjshëm, duke qenë se Partia Demokratike ka kandidatë në Bashkinë e Tiranës, gjithashtu janë edhe disa bashki të tjera të Republikës së Shqipërisë. Ka interes të ligjshëm për sa kohë preket drejtpërdrejt me vendimmarrjen e Komisionerit dhe të KAS-it për sa i përket fletës së votimit dhe pasqyrimit të simboleve, logove, emrit dhe kryetarit të partisë PD. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit!

Z. A. Kaziaj: Nëse mundem, zoti relator?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. L. Braho: Keni prapësime në lidhje me kërkesën?

Z. A. Kaziaj: Po, në lidhje me kërkesën ligjvënësi e ka parashikuar shumë qartë në nenin 133 vijues, ashtu edhe në Kodin e Procedurës Administrative si bëhet një kërkesë për ndërhyrjen e një pale të interesuar. Duhet të bëhet me shkrim e duhet të ishte përpara jush në këtë moment. Faleminderit!

Z. I. Sefa: Mundem, zoti relator? Duke qenë se kërkesa i shqyrtua, në mos gaboj, është dorëzuar në KQZ para një ore a dy orësh, dhe nuk kisha dijeni në lidhje me dorëzimin e kësaj kërkesë. KAS-i, duke mirëkuptuar edhe palët, vendosi ta shqyrtojë menjëherë këtë kërkesë. Ka qenë fizikisht e pamundur, pasi unë kam qenë pjesë edhe në dy seancat e tjera dëgjimore në KAS, që unë si përfaqësues i subjektit të bëja një kërkesë me shkrim për t'ia paraqitur administratës së KQZ-së. Nëse KAS-i dhe pala e konsideron të domosdoshme, për 30 sekonda mund të bëj një kërkesë me shkrim dhe mund t'jua paraqes.

Z. L. Braho: KAS-i i konsultuar në vend vendosi pranimin e kërkesës së përfaqësuesit të Partisë Demokratike për të marrë pjesë si palë e interesuar në këtë kërkesë ankimore.

Z. A. Kaziaj: Edhe pa kërkesë, zoti Braho?

Z. L. Braho: Nëse e do edhe arsyetimin, arsyetimi është...

Z. A. Kaziaj: Do ta gjeni pjesë të vendimit, po.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. L. Braho: Mund edhe të ta them tani. Edhe për ju është fakt i njohur që përfaqësuesi i Partisë Demokratike ka qenë këtu që kur kemi filluar seancën e parë, ka qenë bashkë me ju, ndaj e ka pasur të pamundur objektivisht të depozitonte kërkesë me shkrim.

Z. K. Bele: Prevalon interesi i shpejtësisë në këto çështje, sepse është fletë votimi për t'u printuar.

Z. A. Kaziaj: Pikërisht se është një fletë votimi për t'u printuar, është ajo që tha zoti relator që ka dy orë që është këtu dhe nuk ka pasur akoma interesin për të bërë një kërkesë me shkrim siç Kodi e parashikon. Në qoftë se do të jeni në kapërcim të Kodit, është vendimmarrja juaj.

Z. L. Braho: Zoti Kaziaj, vendimmarrja nuk diskutohet. Keni të drejtë bashkë me vendimin përfundimtar ankimoni edhe këtë. Zoti Merkaj, në lidhje me elementet e formës e të përmbajtjes për këtë kërkesë ankimore.

Z. Y. Merkaj: Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 51 konstatohet se i plotëson të tria elementet e nenit 130 të Kodit Zgjedhor: kompetencë e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit, që në rastin konkret është KAS-i, legjitimitimi i ankuesit, si dhe respekton afatin ligjor për ankimit, është brenda afatit 3-ditor të parashikuar në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për këto arsye kërkojmë kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë publike. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit! Fjala për përfaqësuesit e koalicionit “Bashkë Fitojmë” në lidhje me tri elementet e formës e të përmbajtjes për sa i përket kërkesës ankimore që keni depozituar.

Z. F. Nuri: I nderuar relator, ne kemi depozituar ankimin, në gjykimin tonë, brenda afateve, kemi arritur të kapim orën 4, orën zyrtare të datës 18 prill, pavarësisht që vendimi i Komisionerit është marrë në datën 15 prill, duke gjykuar edhe përmbajtjen e Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 125 “Llogaritja e afateve”, ku pika 2, në mos gaboj, e ka të qartë që kur afatet janë përcaktuar me ditë, llogariten duke përjashtuar ditën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. Ne gjykojmë që jemi brenda afatit prej tre ditësh për depozitim të ankimit. Gjithashtu, kemi interes të ligjshëm në lidhje me kërkimin, përderisa si koalicion jemi subjekt zgjedhor i regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kundërshtojmë nëpërmjet këtij ankimi dy vendimet, të cilat për nga natyra lidhen bashkë dhe do të ishin pa sens po të shkëputeshin, konkretisht vendimet nr.360 dhe nr.363, datë 15.4.2023 nëpërmjet të cilëve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, Bashkia Tiranë, dhe miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki të tjera të vendit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjeve që i bashkëlidheshin vendimeve përkatëse. Ne kemi interes të ligjshëm, sepse përpara se të merrej ky vendim në datën 14 prill me anë të komunikimeve elektronike, por edhe të nesërmen në datën 15 prill në seancë, përfaqësuesit e koalicionit “Bashkë Fitojmë” i kanë kërkuar zyrtarisht Komisionerit, zotit Celibashi, të mos përfshijë emblema dhe logo koalicionesh dhe as logo të partive politike te fleta për kryetar bashkie në zgjedhjet e 14 majit. Arsyet janë se, së pari, jemi përpara zgjedhjeve të pushtetit vendor ku qytetarët do të zgjedhin

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

kryetarët e bashkive dhe jo kryetarin e ndonjë partie politike dhe nuk ka pse, në gjykimin tonë, të identifikohet kryesisht emri i kryetarit të partisë apo i koalicionit. Së dyti, nuk jemi përpara zgjedhjeve të përgjithshme ku kandidatët identifikohen me partinë apo koalicionin që e ka propozuar në listat shumëmemërore, kjo është pjesa e fletës së dytë të votimit, fleta ku njerëzit kanë të drejtë të votojnë për subjektin politik, kurse ankimi ka të bëjë posaçërisht me përmbajtjen e fletës së votimit të kandidatëve. Së treti, është praktika e KQZ-së e ndjekur edhe herët e kaluara, për shembull në vitet 2015 dhe 2019, mund t'jua vë në dispozicion, ku fletët e votimit janë publike, meqenëse edhe në seancën e kaluar paraqiti kolegu disa foto, kemi edhe në disa foto, modelet e vitit 2019 për kryetar bashkie dhe, siç shihet qartë, nuk ka asnjë logo, apo të marra nga *web*-i këto të vitit 2015. Ky shkrimi “Unë votoj për azil në Gjermani” nuk ka lidhje me këtë, këtu duket, Sazan Guri, Halim Mesut Kosova, Dhimitër Zef Muslia dhe Arben Zyhdi Tafaj për Bashkinë Tiranë, janë numrat rendorë dhe nuk ka asnjë logo. Pra, kanë qenë pa logo fletët e kandidatit, nuk po flas për fletët e subjekteve për proporcionalin, por për kandidatët. Pa e zgjatur ne kërkojmë të legjitimohemi dhe të shqyrtojmë thelbin e kërkesës sonë nga ana e KAS-it.

Z. L. Braho: Faleminderit! Zoti Kaziaj, do të shtoni diçka?

Z. A. Kaziaj: Thjesht për të specifikuar faktin lidhur me pyetjen tuaj që bëtë pak më parë për çfarë e kemi ankimuar ne pjesën e logos, jo vetëm për atë që ne mendojmë që tashmë është një praktikë e konsoliduar e këtij institucioni, pavarësisht ndryshimeve që janë bërë në këtë institucion, por në vetvete edhe për të rritur pak edhe atë që është vetë qëllimi, *racio*-ja e një flete votimi për kryetar bashkie, që në vetvete nuk është subjekti, por është personi që do të drejtojë bashkinë të paktën për

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

4 vjetët e ardhshëm. Qëllimi në vetvete duhet të jetë tek emri i personit dhe kjo duhet të jetë në fokusin kryesor, pavarësisht logos së subjektit politik që i përket kandidati për kryetar bashkie. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Kaziaj! Po, zoti Sefa.

Z. I. Sefa: Së pari, unë mendoj që është jashtë afatit të përcaktuar në dispozitat e ligjit për sa kohë që edhe vendimmarrja e Komisionerit është përcaktuar në orë, në mos gabo, ora e referuar në atë vendimmarrje është 10.30, ditë e shtunë. Unë përsëri jam i mendimit që për sa kohë në vendimmarrje thuhet që afati fillon menjëherë me shpalljen e këtij vendimi dhe ligji e përcakton qartë që afati fillon menjëherë, pavarësisht dispozitës së përmendur nga kolegu më parë. Gjithashtu, në rast se kolegu pretendon që është brenda afatit, përsëri unë jam i mendimit që afati mbaronte sot në orën 10.30 dhe jo në orën 16 pa 5 minuta që është paraqitur kërkesa, pavarësisht se vendimi i Komisionerit referohet me ditë, përsëri unë marr për bazë orën e dhënies së vendimit dhe eci tri ditë nga ora dhe i binte që sot në orën 10.30 do të ishte edhe afati i fundit për paraqitjen e kërkesës ankimore të këtyre vendimeve. Për sa u përket formës dhe përmbajtjes, në qoftë se KAS-i mendon që është paraqitur brenda afatit zyrtar të parashikuar në Kodin Zgjedhor, mendoj ta kalojmë në seancë themeli dhe palët të argumentojnë të gjitha pretendimet e tyre. Faleminderit!

Z. L. Braho: Po.

Z. K. Bele: Ju kërkoni që të jetë emri pa emrin e subjektit poshtë? Pra, vetëm emrin?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. A. Kaziqaj: Jo vetëm për logon është bërë, zoti Bele. Emri i subjektit poshtë le të jetë, se ashtu kanë qenë edhe praktikatat e mëparshme që zoti Nuri i bëri prezent edhe pranë këtij komisioni, kështu që identifikues është edhe emri i subjektit në vetvete. Thjesht logoja nuk ka qenë *modus operandi* i këtij institucioni.

Z. K. Bele: Po në rastin e emrave të ngjashëm si do bëhet? Për shembull, në Lushnjë kemi Eriselda Sefa, Indrit Sefa.

Z. A. Kaziqaj: I kemi pasur, nuk i kemi më. Zoti Sefa dështoi me sukses, kështu që nuk e kemi më.

Z. L. Braho: Ato fletët paskan qenë me logo. Po kjo KQZ, fletët për kryetar bashkie kanë qenë me logo.

Z. A. Kaziqaj: Për çfarë viti flasim? 2021?

Z. L. Braho: Në vitin 2022.

Z. A. Kaziqaj: Ishin zgjedhjet e pjesshme lokale të vitit 2022.

Z. L. Braho: Të pjesshme, por janë me logo.

Z. A. Kaziqaj: Ishin zgjedhje atipike, zotni.

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.04.2023*

Z. L. Braho: Atëherë, KAS-i, i konsultuar në vend, vendosi kalimin për shqyrtim në seancë të kërkesës ankimore nr. 51. Seanca për shqyrtimin e kësaj kërkesë do të bëhet nesër në datën 19 prill 2023 në orën 17.30. Seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 59

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

